

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë ë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi, anëtarë me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit F.Sh., nga fshati O., komuna e V., për shkak të veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, dhe përdorimi i paautorizuar i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë-Dega në Skenderaj P.nr.151/2016 datë 22.03.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.696/2017 datë 27.07.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28 maj 2018 mori këtë :

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit F.Sh., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë - Dega në Skenderaj P.nr.151/2016 datë 22.03.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.696/2017 datë 27.07.2017.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë - Dega në Skenderaj, P.nr.151/2016 datë 22.03.2017, i dënuari F.Sh., sipas pikës I dhe II të dispozitivit, është shpallur fajtor për veprat penale përdorimi i paautorizuar i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, kurse sipas pikës III në bashkëkryerje me të pandehurin A.Sh.: për veprën penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me par.1 dhe neni 31 të KPK, sipas pikës IV për shkak të veprës penale në, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, ndërsa sipas pikës V të dispozitivit veprën penale kanosje nga neni 185 par.4 lidhur me par.3 dhe 2 e lidhur me neni 31 të KPK dhe pasi

që më parë gjykata i ka përcaktuar dënimet për secilën veprë veç e veç dhe atë: për veprën penale nga pika I dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €; për veprën penale nën pikën II dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €; për veprën nën pikën III dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajsh; për veprën penale nën pikën IV dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajsh, kurse për veprën penale nën pikën V dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe me aplikimin e dispozitës së nenit 80 par.1 dhe 2 të KPK, është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh dhe dënim me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind)€, të cilën është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, e nëse gjoba nuk paguhet në afatin e caktuar, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim sipas nenit 46 par.3 të KPK.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.696/2017 datë 27.07.2017, sipas pikës I të dispozitivit, ka refuzuar ankesën e të dënuarit F.Sh., në raport me veprat penale përdorimi i paautorizuar i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK dhe në këtë pjesë e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë. Ndërsa, sipas pikës II të dispozitivit, me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore dhe ankesave të mbrojtësve të dënuarve A.Sh. dhe F.Sh., aktgjykimi i shkallës së parë në raport me veprat penale sipas dispozitivit 3,4 dhe 5 është anuluar dhe çështja në këtë pjesë është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Kundër këtyre aktgjytimeve, për pjesën e formës së prerë, kërkesë mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit F.Sh., G.R., avokat nga M., për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen pa konkretizuar se në çfarë kuptimi, ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokurori i Shteti të Kosovës me parashtresën KMLP.II.nr.90/2018 datë 27.04.2018 ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit, për faktin se i njëjti është shpallur fajtor dhe gjykuar për veprën penale përdorimi i paautorizuar i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të

armëve nga neni 374 par.1 të KPK, dhe kështu gjykata i ka shqiptuar dy dënime duke shkelur ligjin penal sepse vepra penale e mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e konsumon veprën penale të përdorimit të paautorizuar të armës.

Gjykata Supreme, i vlerëson si të pabazuara pretendimet e lartcekura nga këto arsye:

Në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër armëve (**kapitulli XXX**), Kodi Penal i Kosovës ka paraparë gjashtë (6) vepra të ndryshme penale, secila nga këto vepra penale ka tiparet e veta. Në kuadër të këtij kapitulli ligdhënësi ka sanksionuar mbajtjen në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, të parashikuar nga neni 374 dhe përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm, të parashikuar nga neni 375 të KPK-ës. Kur kemi të bëjmë me përdorimin e armës, këtë vepër penale mund ta kryej si personi i cili posedon leje për mbajtjen e armës, po ashtu edhe ai i cili nuk posedon leje për mbajtje të armës. Mbajtja e armës pa leje, nuk e konsumon veprën penale të përdorimit të armës, sikundër nuk e përjashton veprën penale të përdorimit të armës, nga ana e personit i cili posedon leje për mbajtje të armës, nëse përdorimi ka ndodhur në kundërshtim me ligjin.

Nëse i referohemi standardit të konsumimit eventual të veprës penale, atëherë vepra penale më e rëndë e konsumon atë më të lehtë, ndërsa në rastin konkret maksimumi i dënimit për armëmbajtje pa leje sipas par.1 të nenit 374 të KPK është 5 vite, ndërsa maksimumi i dënimit për përdorimin e armës sipas nenit 375 par.1 të KPK është 8 vite, prandaj shtrohet pyetja se si është e mundur vepra më e lehtë të konsumoj atë më të rëndë (siç pretendohet në kërkesë).

Konsumimi i veprës penale të përdorimit të armës (**375**), të cilën kryesi po e mbante pa leje, nga vepra penale e armëmbajtjes pa leje (**neni 374**) do vinte në shprehje psh. kur kryerësi me këtë armë ka tentuar të privoj dikë nga jeta, por jo edhe në rrethanat tjera, siç kemi të bëjmë me rastin konkret. Nga këto arsye pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se është shkelur ligjit në dëm të tij dalin të pabazuara.

Nga arsyet e cekura më sipër, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar se e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRIOSHTINË
PML.nr.121/2018, më 28 maj 2018

Procesmbajtësja,
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta